

**LIGJI NR.08/L-295**

**PËR KRIPTO-ASETET**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR KRIPTO-ASETET**

**KAPITULLI I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

1. Ky ligj ka për qëllim të rregullojë:

- 1.1. Licencimin, autorizimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve që ushtrojnë veprimtari të ndërlidhur me emetimin, shpërndarjen, tregtimin dhe ruajtjen e kryptoaseteve;
- 1.2. Kushtet e operimit dhe organizimit të operatorëve në fushën e emetimit, tregtimit dhe ruajtjes së kryptoaseteve;
- 1.3. Kushtet dhe kriteret për transparencë gjatë emetimit dhe tregtimit të kryptoaseteve në platforma tregtare;
- 1.4. Rregullat për mbrojtjen e konsumatorëve lidhur me shërbimet e operatorëve për emetimin, tregtimin, shkëmbimin, ruajtjen dhe shërbimet e konsulencës, lidhur me kryptoasetet;
- 1.5. Sanksionet në rastin e praktikave abuzive; dhe
- 1.6. Çështje të tjera që lidhen me shërbimet në fushën e teknologjisë së regjistrave të shpërndarë.

2. Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Rregulloren (BE) 2023/1114 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 31 maj 2023, mbi tregjet e kryptoaseteve dhe që ndryshon Rregulloret (BE) nr.1093/2010 dhe (BE) nr.1095/2010, Direktivat 2013/36/BE dhe (BE) 2019/1937.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të gjitha veprimtaritë që ndërlidhen me: këshillëdhënien, emetimin, shpërndarjen, tregtimin dhe ruajtjen e kryptoaseteve, për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që ushtrojnë veprimtari të tillë në territorin e Republikës së Kosovës, ose nga Republika e Kosovës për klientë që ndodhen jashtë saj.

2. Përveç nëse parashihet ndryshe, shprehimisht me dispozita të këtij ligji, ky ligj nuk zbatohet për subjektet e mëposhtme:

- 2.1. Institucionet publike;
- 2.2. Bankën Qendrore të Kosovës;
- 2.3. Kompanitë e sigurimit dhe risigurimit; dhe
- 2.4. Administratorët e falimentimit.

### **Neni 3 Përkufizimet**

1. Në këtë ligj, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

- 1.1. **Agjenti** - personi juridik i licencuar për teknologji digjitale të bazuar në DLT;
- 1.2. **Aplikues** - është çdo person fizik apo juridik që plotëson një aplikim për licencë ose për marrjen e një autorizimi sipas këtij ligji;
- 1.3. **Aset real** - secila valutë, aksion, kuotë, aset fizik ose vlerë tjetër reale, përjashtimisht kryptoaseteve, e cila mund të këmbehet në tregje reale apo digjitale;
- 1.4. **Autoritetet përgjegjëse** - autoritetet përgjegjëse janë: BQK, ATK dhe NJIF;
- 1.5. **Autorizimi** - autorizimet që ndërlidhen me shërbimet për tregtimin e kryptoaseteve të parapara me Kapitullin II;
- 1.6. **ATK** - Administrata Tatimore e Kosovës;
- 1.7. **Akt ose transaksion i dyshimtë** - akti ose transaksioni i kryer ose i tentuar, që krijon dyshim të bazuar se pasuria e përfshirë në aktin apo transaksionin e kryer apo të tentuar, është produkt i krimit, apo ndërlidhet me financimin e terrorizmit dhe interpretohet në përputhje me çdo akt nënligjor të lëshuar nga NJIF-ja për aktet apo transaksionet e dyshimta;
- 1.8. **BQK** - Banka Qendrore e Kosovës;
- 1.9. **ARBK** - Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës;
- 1.10. **Deklarata mbi përputhshmërinë** - është deklarata e përgatitur dhe nënshkruar nga aplikuesi, nëpërmjet së cilës ky i fundit deklaron se përmbush të gjitha kushtet, kriteret dhe detyrimet e përcaktuara në këtë ligj;
- 1.11. **DLT (Teknologjia e Regjistrimit të Shpërndarë)** - është një bazë e decentralizuar e të dhënave, në të cilën informacioni dhe/ose të dhënat regjistrohen në mënyrë të sigurt, verifikohen në mënyrë konsensusale dhe shpërndahen në mënyrë të sinkronizuar nëpërmjet një rrjeti të shumëfishtë nyjesh ose mjeteve të tjera teknike, ku të gjitha kopjet e bazës së shpërndarë të të dhënave, konsiderohen origjinale;

- 1.12. **Emetues** - është çdo person fizik dhe juridik në Republikën e Kosovës, që emeton tokenë digjitale dhe valuta virtuale në përputhje me këtë ligj;
- 1.13. **Institucion publik** - institucion i Republikës së Kosovës i themeluar me ligj;
- 1.14. **Ministria** - Ministria përgjegjëse për Financa;
- 1.15. **Aset virtual/kriptoaset** - një paraqitje digjitale të vlerës apo të drejtës, e cila mund të transferohet apo të ruhet në mënyrë elektronike, duke përdorur DLT ose teknologji të ngjashme;
- 1.16. **Libri i Bardhë** - është një dokument gjithëpërfshirës që përshkruan aspektet teknike dhe ekonomike të një kryptoaseti;
- 1.17. **NJIF** - Njësia për Inteligjencë Financiare e Republikës së Kosovës;
- 1.18. **Operator** - çdo person i regjistruar, licencuar apo autorizuar sipas këtij ligji për të ofruar shërbime të krypto-aseteve;
- 1.19. **Operatori i autorizuar** - është çdo person që është bartës i autorizimit;
- 1.20. **Operator i licencuar** - është çdo person juridik që është bartës i licencës;
- 1.21. **Para/valutë FIAT** - janë mjetet financiare në formën e bankënotave dhe të parave metalike, vendase ose të huaja, të cilat kanë kurs ligjor;
- 1.22. **Person** - personi fizik ose personi juridik ose ndonjë shoqëri tjetër personash të regjistruar sipas Ligjit përkatës për shoqëritë tregtare ose Ligjit përkatës për organizatat jo-qeveritare;
- 1.23. **Person juridik** - personi juridik sipas Ligjit përkatës për shoqëritë tregtare;
- 1.24. **Sistem i verifikimit të klientit** - procedura e paraparë me Ligjin përkatës për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit;
- 1.25. **Token digjital** - është një shënjes digjital, i cili:
- 1.25.1. është drejtpërdrejtë i varur prej teknologjisë DLT; dhe
  - 1.25.2. bie ekskluzivisht në një nga kategoritë e tokenëve digjitalë të listuar më poshtë:
    - 1.25.2.1. token digjital i pagesave;
    - 1.25.2.2. token digjital i titujve;
    - 1.25.2.3. token digjital i shërbimeve; ose
    - 1.25.2.4. token digjital i aseteve.

1.26. **Transaksion** - secili transferim i të drejtave, të valutave, aseteve digjitale apo kryptoaseteve, të bazuar në një marrëveshje të shkruar apo marrëveshje gojore në mes të dy ose më shumë personave;

1.27. **Manipulim i tregut** - është veprim i qëllimshëm ose i pamatur, me çfarëdo mjeti, e çdo personi ose subjekti, për të krijuar një përshtypje të rreme ose mashtruese të ofertës, kërkesës ose çmimit të çdo asemi virtual ose për të ngritur, ose ulur artificialisht çmimin e çdo asemi virtual;

1.28. **Abuzimi i tregut** - është çdo sjellje ose praktikë joetike dhe e paligjshme që manipulon ose shtrembëron çmimin ose vlerën e aseteve virtuale, ose instrumenteve të lidhura me to dhe cenon funksionimin ose integritetin normal të tregut të aseteve virtuale.

## KAPITULLI II DETYRIMI PËR LICENCIM DHE AUTORIZIM

### Neni 4

#### Detyrimi për licencim dhe autorizim

1. Asnjë operator nuk mund të emetojë, tregtojë, shpërndajë apo ruajë kryptoasete ose të ofrojë ndonjë shërbim tjetër që ndërlidhet me kryptoasetet, përveç nëse është në posedim të licencës apo autorizimit.

2. Autorizimit ose licencimit sipas kushteve të parapara me këtë ligj, nuk i nënshtrohen rastet kur përmes dispozitave të këtij ligji shprehimisht veprimtaria është e liruar nga marrja e licencës apo autorizimit.

### Neni 5

#### Licencat për operim

1. Licencat që miratohen nga autoritetet përgjegjëse për kryerjen e veprimtarive të parashikuara në këtë ligj janë:

1.1. Licenca për shërbime të administrimit të portofolit dhe shërbimeve tjera për palë të treta - agjenti;

1.2. Licenca për operimin e platformës tregtare online dhe/ose me bazë fizike (këmbimore) të kryptoaseteve kundrejtë valutës fiat ose kryptoaseteve të tjera, me seli në Republikën e Kosovës;

1.3. Licencimi për operimin e kryptoatm apo bankomatëve të kryptovalutave;

1.4. Licencimi për operatorë me veprimtari me karakteristika të veçanta, siç përcaktohet me nenin 7 të këtij ligji;

1.5. Licencimi për emetimin e tokenëve digjitalë të ndërlidhur me një aset real; dhe

1.6. Licencimi lidhur me emetimin e tokenëve digjitalë, që nuk ndërlidhen me një aset real.

2. Autoriteti përgjegjës me akt nënligjor përcakton kriteret e licencimit për të gjitha licencat sipas paragrafit 1 të këtij neni.

### **Neni 6 Autorizimet për operim**

1. Llojet e autorizimeve që miratohen nga autoritetet përgjegjëse për kryerjen e veprimtarive të parashikuara me këtë ligj janë:

1.1. Autorizimi për lansimin e kryptoaseteve; dhe

1.2. Autorizimi për dhënien e këshillave për kryptoasetet.

2. Autoriteti përgjegjës me akt nënligjor përcakton kriteret për autorizimet sipas paragrafit 1 të këtij neni.

### **Neni 7 Veprimtaritë me karakteristika të veçanta**

1. Subjektet që kanë si veprimtari mihjen e kryptoaseteve dhe emetimit të kryptoaseteve, në mënyrë indirekte përmes procedurës së mihjes, operojnë me kufizime sipas paragrafit 2 të këtij neni.

2. Mihja e kryptoaseteve me këtë ligj, lejohet vetëm përmes furnizimit me energji në treg të liberalizuar apo përmes vet-gjenerimit nga burime të ripërtëritshme të energjisë.

3. Veprimet në kundërshtim me paragrafin 2 të këtij neni do të sanksionohen sipas dispozitave të parapara ligjore, të cilat e ndalojnë furnizimin ilegal me energji elektrike.

## **KAPITULLI III KUSHTET E PËRGJITHËSHME PËR LICENCIM DHE/OSE AUTORIZIM DHE KOMPETENCAT E AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE**

### **Neni 8 Kushtet e përgjithshme për licencim dhe/ose autorizim**

1. Çdo aplikues për licencim dhe/ose autorizim duhet të dëshmojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet agentit, se i përmbush të gjitha kushtet e përgjithshme të përcaktuara në këtë nen, si në vijim:

1.1. të vërtetojë pagesën e taksës për aplikim;

1.2. të vërtetojë që aplikuesi është i regjistruar pranë ARBK-së;

1.3. të vërtetojë, se ka strukturë të kompletuar dhe funksionale sipas Ligjit përkatës për shoqëritë tregtare;

1.4. të bashkëngjësë biografinë/evidencën mbi reputacionin profesional dhe personal, për të kryer detyrat e tyre dhe janë në gjendje të kuptojnë qartësisht llojin e aktiviteteve dhe rreziqet që lidhen me to;

- 1.5. të vërtetojë, duke siguruar një kopje të dokumentit përkatës se ka emëruar së paku një (1) person përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave në nivele administrimi/drejtues në zyrën qendrore.
2. Aplikuesi për licencim/autorizim duhet të ketë një person kontakti ose të autorizuar me prezencë fizike në Republikën e Kosovës, përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave, i cili do t'i nënshtrohet legjislacionit në fuqi.
3. Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar e tij.
4. Përveç kushteve të përgjithshme për licencim dhe/ose autorizim të përcaktuar më këtë ligj, BQK me akt nënligjor përcakton procedurat dhe kushtet specifike për licencim/autorizim që të duhet t'i përmbushë aplikuesi.

### **Neni 9** **Aplikimi për licence dhe/ose autorizim**

1. Pas plotësimit të formularit të aplikimit, aplikuesi e dorëzon atë pranë autoritetit përgjegjës, duke bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin për përmbushjen e kushteve të përgjithshme dhe kriterëve të veçanta, si dhe çdo kërkesë tjetër sipas dispozitave të këtij ligji.
2. Aplikimi për licencim/autorizim dhe dokumentacioni provues mund të dorëzohet edhe në formë elektronike, sipas rregullave përkatëse.
3. Aplikimi për licencë bëhet nga vet aplikuesi.
4. Aplikimi për autorizimet e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji, mund të bëhet nga vet aplikuesi, apo përmes agjentit.

### **Neni 10** **Afatet e procedurës së licencimit dhe/ose autorizimit**

1. Autoriteti përgjegjës merr vendim në lidhje me licencimin dhe/ose autorizimin pas aplikimit dhe dokumentacionit nga vet aplikuesi ose nëpërmjet agjentit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
2. Procedurat e shqyrtimit të aplikacionit rregullohen me akt nënligjor, të nxjerrë nga autoriteti përgjegjës.

### **Neni 11** **Kompetencat e autoriteteve përgjegjëse gjatë procedurës së licencimit dhe/ose autorizimit**

1. Autoriteti përgjegjës mund të kërkojë, për llogari të tij ose me kërkesë të autoritetit bashkëveprues, sqarime të mëtejshme ose dokumentacion plotësues nga aplikuesi, brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni.
2. Kërkesa për sqarime të mëtejshme dhe/ose dokumentacioni plotësues duhet të jetë e argumentuar mirë, të jetë konkrete në kërkesa dhe duhet të përmbajë arsyet e specifikuar të lidhura me këtë kërkesë.

3. Nëse aplikuesi nuk arrin të sigurojë sqarimet dhe/ose dokumentacionin e kërkuar brenda dhjetë (10) ditëve të punës ose kur në varësi të rrethanave, autoriteti përgjegjës vendosë për një afat më të gjatë, por jo më shumë se njëzet (20) ditë pune, pas së cilës datë aplikimi do të konsiderohet automatikisht i refuzuar.

### **Neni 12** **Obligimet e operatorëve të licencuar**

1. Operatorët e licencuar janë të detyruar të ndërmarrin veprimet dhe masat për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit para, gjatë, dhe pas ekzekutimit të transaksionit ose krijimit të marrëdhënies afariste, siç përcaktohen në Ligjin përkatës për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit në fuqi, duke mos u limituar, si në vijim:

1.1. pajtueshmërinë me të gjitha kërkesat e kujdesit të duhur ndaj klientit - veçanërisht, për të mbledhur dhe mbajtur informacionin e autorit dhe të përfituesit të kërkuar sipas "rregullit të udhëtimit" të përcaktuar me legjislacionin vendor;

1.2. monitorimin e të gjitha transaksioneve në platformën e transaksioneve për "aktivitet të dyshimtë";

1.3. monitorimin e transaksioneve dhe kontrollimin e sanksioneve duke përdorur kontrollin, i cili përfshin softuer që mundëson rishikimin dhe analizën e lëvizjeve të DLT (blockchain) dhe zbulimin e teknologjisë së anonimizimit; dhe

1.4. siguroj një kopje të vlerësimi të rrezikut të kompletuar për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për mbarë biznesin, siç kërkohet me Ligjin përkatës për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

2. Operatorët (ofruesit e shërbimeve të aseteve virtuale) raportojnë tek NjIF-K, sipas mënyrës dhe formës së specifikuar nga NjIF-K të përcaktuar me Ligjin përkatës për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

### **Neni 13** **Refuzimi i dhënies së licencës dhe/ose autorizimit**

1. Dhënia e licencës dhe/ose autorizimit do të refuzohet nga autoritetet përgjegjëse, për shkaqet e mëposhtme:

1.1. mospagesa e tarifës për aplikimin për licencë dhe/ose autorizim nga ana e aplikuesit;

1.2. pas konstatimit nga autoritetet përgjegjëse, se aplikuesi ka dorëzuar dokumentacion me informacion të rremë, dhe/ose të pasaktë ose jo të plotë; dhe

1.3. pas konstatimit nga autoritetet përgjegjëse në përputhje me Ligjin përkatës për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, ka dyshim të bazuar se aplikuesi, licencën dhe/ose autorizimin synon ta përdorë për pastrim parash ose financim të terrorizmit nëpërmjet veprimtarisë me kryptoasete.

2. Nëse autoritetet përgjegjëse refuzojnë dhënien e licencës dhe/ose autorizimit, apo aplikimi është tërhequr vullnetarisht nga aplikuesi, riaplikimi nuk mund të bëhet pa kaluar tre (3) muaj nga dita e refuzimit. Riaplikimi do të trajtohet si një aplikim i ri.

3. Autoriteti përgjegjës për licencim/autorizim mban të dhëna kur aplikantët zgjedhin të tërheqin vullnetarisht aplikimin e tyre për licencim dhe/ose autorizim.

#### **Neni 14** **Autoritetet përgjegjëse**

1. Licencat e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji, lëshohen nga BQK, pas komunikimit me NJIF dhe institucione tjera relevante, varësisht nga lloji i licencës.

2. Autorizimet e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji, lëshohen nga BQK, pas komunikimit me NJIF dhe institucione tjera relevante, varësisht nga lloji i autorizimeve.

#### **Neni 15** **Statusi i licencave dhe/ose autorizimeve**

1. Me qëllim që të lejohet të ushtrojë veprimtarinë e parashikuar në licencë dhe/ose autorizimin përkatës, bartësi i licencës/autorizimit duhet të vazhdojë të jetë në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

2. Çdo licencë dhe/ose autorizim i lëshuar është e revokueshme nga institucioni i cili e lëshon, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

3. Detyrimet e përgjithshme të bartësit të licencës dhe/ose autorizimit ndaj klientëve të tyre ose palëve të treta, janë si më poshtë:

3.1. të veprojë me ndershmëri;

3.2. të ofrojë shërbimet pa paragjykime;

3.3. të silllet në mënyrë profesionale; dhe

3.4. të zbatojë të gjitha rregullat e përcaktuara në këtë ligj, si dhe dispozitat tjera ligjore ose nënligjore, që mund të jenë të zbatueshme për bartësin e autorizimit.

#### **Neni 16** **Vlefshmëria dhe kohëzgjatja e licencave dhe/ose autorizimeve**

Licenca dhe/ose autorizimi do të fillojë të jetë e vlefshme një (1) ditë pas marrjes së njoftimit nga autoriteti përgjegjës në lidhje me miratimin e kërkesës për licencim dhe/ose autorizim dhe do të zgjasë për një kohë të pacaktuar, përveç rasteve kur autoriteti përgjegjës ka revokuar licencën dhe/ose autorizimin.

### **Neni 17** **Koordinimi mes autoriteteve**

Koordinimi mes autoritetit përgjegjës dhe institucioneve relevante në miratimin dhe lëshimin e autorizimit dhe/ose licencës përkatëse ose në rast të ushtrimit të çdo lloji detyre të përbashkët të përcaktuar në këtë ligj, rregullohet me akt nënligjor nga ministria.

### **Neni 18** **Përgjegjësitë e përgjithshme në kuadër të parandalimit të pastrimit të parave**

1. Çdo bartës i licencës dhe/ose autorizimit do të konsiderohet si subjekt raportues sipas Ligjit përkatës për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.
2. Çdo bartës i licencës dhe/ose autorizimit do t'i nënshtrohet obligimeve të subjekteve raportuese, posaçërisht obligimeve që rrjedhin nga Ligji përkatës për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.
3. NjIF-K dhe BQK janë autoritete kompetente për inspektimin dhe mbikëqyrjen e pajtueshmërisë së operatorëve të përcaktuar sipas këtij ligji, bazuar në dispozitat e Ligjit përkatës për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit .
4. Inspektimi dhe mbikëqyrja e pajtueshmërisë sipas paragrafit 3 të këtij neni, do të bëhet në përputhje me kompetencat mbikëqyrëse të NjIF-K të përcaktuara sipas Ligjit përkatës për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, përfshirë edhe ndëshkimet administrative dhe masat për përmirësim.

### **Neni 19** **Pezullimi dhe revokimi i licencës dhe/ose autorizimit**

1. BQK mund të pezullojë dhe/ose revokojë licencën dhe/ose autorizimin në rastet e mëposhtme:
  - 1.1. një licencë dhe/ose autorizim mund të pezullohet dhe më pas revokohet nëse autoritetet përgjegjëse gjykojnë në mënyrë të arsyeshme se operatori i licencuar/autorizuar:
    - 1.1.1. nuk arrin t'i përmbushë më kushtet e përgjithshme dhe/ose kriteret e veçanta të përcaktuara në këtë ligj;
    - 1.1.2. iu ka dhënë autoriteteve përgjegjëse informacion të rremë ose të pasaktë; dhe
    - 1.1.3. është në kundërshtim ose nuk përmbushë më një ose më shumë nga kushtet e përgjithshme dhe/ose kriteret e veçanta të parashikuara nga ky ligj.
2. Në të tilla raste, autoriteti përgjegjës pezullon licencën dhe i jep bartësit të saj një afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë pune ose, në varësi të rrethanave, një afat më të gjatë, por jo më shumë se njëzetepesë (25) ditë pune, nga data e njoftimit të vendimit që shpjegon arsyet e pezullimit, për të parashtruar qëndrimet e tij në lidhje me vendimin e pezullimit e licencës.

3. Nëse operatori i licencuar/autorizuar nuk arrin të përgjigjet brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, autoriteti përgjegjës revokon licencën, duke argumentuar në vendim arsyet e revokimit.

4. Licenca dhe/ose autorizimi, gjithashtu mund të revokohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga autoriteti përgjegjës, në rastet e mëposhtme:

4.1. kur operatori i licencuar/autorizuar nuk fillon veprimtarinë për të cilën është licencuar brenda gjashtë (6) muajsh nga data e lëshimit të licencës dhe/ose autorizimit;

4.2. kur operatori i licencuar/autorizuar bëhet subjekt i një procesi likuidimi ose shpall falimentimin; dhe

4.3. nëse ndonjë institucion relevant që disponon kompetenca në lidhje me operatorin e licencuar/autorizuar, kërkon me shkrim dhe mbi baza të arsyeshme revokimin e licencës dhe/ose autorizimit.

## **KAPITULLI IV REGJISTRAT**

### **Neni 20**

#### **Mirëmbajtja dhe përditësimi i regjistrit**

1. Çdo operator që bartë licencë apo autorizim, do të publikohet në regjistër publik, i cili mirëmbahet nga BQK.

2. Regjistri do të përditësohet rregullisht, dhe në çdo rast, të paktën çdo dymbëdhjetë (12) muaj, duke filluar nga data në të cilën licenca është lëshuar.

3. Regjistrimi i licencave/autorizimeve dhe çdo vendimi tjetër i autoriteteve përgjegjëse duhet të kryhet sipas përcaktimeve të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

## **KAPITULLI V EMEMENTIMI, LANSIMI I TOKENËVE DHE LIBRI I BARDHË**

### **Neni 21**

#### **Detyrimet e Emetuesve**

1. Një emetues duhet:

1.1. të ushtrojë veprimtarinë e tij me ndershmëri dhe integritet;

1.2. të ushtrojë veprimtarinë e tij duke marrë parasysh interesat dhe nevojat e gjithësecilit prej blerësve të tokenëve digjitalë/valutave virtuale gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij;

1.3. të trajtojë në mënyrë të drejtë, të qartë dhe jo abuzive të gjithë blerësit e tokenëve digjitalë /valutave virtuale;

1.4. të ketë një kod të përshtatshëm të qeverisjes korporative;

1.5. të mirëmbajë protokollet e sistemit dhe të sigurisë në standardet më të larta të përshtatshme;

1.6. të vendosë, vet ose nëpërmjet një pale të tretë, sisteme për parandalimin, zbulimin dhe eleminimin e riskut të krimit financiar;

1.7. të vendosë, vet ose nëpërmjet një pale të tretë, sisteme për parandalimin, zbulimin dhe eleminimin e riskut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit; dhe

1.8. të ketë burime financiare të mjaftueshme.

2. Kur një emetues zotëron një ueb-faqe ku është i detyruar të publikojë çdo njoftim apo informacion për publikun sipas përcaktimeve të këtij ligji, ky detyrim do të konsiderohet i përmbushur në rastet kur emetuesi publikon një informacion apo njoftim të tillë në ueb-faqen e tij.

## **Neni 22**

### **Kushtet për lansimin e tokenëve digjital**

1. Lansimi i produkteve të tokenëve digjital dhe kërkesa për listimin dhe tregtimin e tokenëve digjitalë dhe/ose valutave virtuale në platftomat tregtare digjitale, do të mund të bëhet vetëm pasi emetuesi të ketë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme në mënyrë kumulative:

1.1. të hartojë, sipas specifikës së rastit, Librin e Bardhë (Whitepaper), i cili duhet të jetë në përputhje me të gjitha kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë ligj; dhe

1.2. të dorëzojë tek autoriteti përgjegjës, kërkesën për autorizimin e tokenit digjital dhe sipas kërkesës përkatëse ligjore, Librin e Bardhë Prospektin.

## **Neni 23**

### **Libri i Bardhë**

1. Libri e Bardhë i Kripto-Asetit do të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

1.1. një përshkrim të detajuar të emetuesit, duke përfshirë një përmbledhje të informacionit kryesor financiar në lidhje me emetuesin dhe një përshkrim të detajuar të pjesëmarrësve kryesorë të përfshirë në hartimin dhe zhvillimin e projektit;

1.2. një numër telefoni kontakti dhe një adresë emaili të emetuesit;

1.3. një përshkrim të detajuar të projektit të emetuesit, llojin e kripto-asetit që do t'i ofrohet publikut për të cilin kërkohet pranimi në treg;

1.4. nëse është i ndryshëm nga emetuesi dhe operatori, identiteti i personit që ka përgatitur Librin e Bardhë të kripto-asetit dhe arsyen pse ai person ka përgatitur Librin e Bardhë të kripto-asetit;

1.5. informacion mbi treguesit e qëndrueshmërisë në lidhje me emetimin e kripto-asetit;

- 1.6. një përshkrim të detajuar të karakteristikave të ofertës për publikun, në veçanti numrin e krypto-aseteve që do të emetohen ose për të cilat kërkohet pranimi në treg, çmimi i emetimit të krypto-aseteve dhe kushtet e abonimit;
  - 1.7. një përshkrim të detajuar të të drejtave dhe detyrimeve të bashkangjitura me krypto-asetet dhe procedurat dhe kushtet me të cilat emetuesi, ofruesi dhe konsumatori do të lejohen të ushtrojnë këto të drejta; dhe
  - 1.8. informacion mbi teknologjinë, protokollet dhe standardet themelore të aplikuara nga emetuesi i krypto-aseteve që lejojnë mbajtjen, ruajtjen dhe transferimin e këtyre krypto-aseteve.
2. Libri i Bardhë i krypto-asetit duhet të përmbajë deklaratën e mëposhtme: “Emetuesi i Kripto-Asetit është i vetmi përgjegjës për përmbajtjen e këtij Libri të Bardhë të Kripto-Asetit”.
  3. Libri i Bardhë i krypto-asetit duhet të përmbajë një deklaratë të qartë se:
    - 3.1. krypto-asetet mund të humbasin vlerën e tyre pjesërisht ose plotësisht;
    - 3.2. krypto-asetet mund të mos jenë gjithmonë të transferueshme;
    - 3.3. krypto-asetet mund të mos jenë likuide; dhe
    - 3.4. kur oferta për publikun ka të bëjë me tokenat e shërbimeve, që këto tokena të shërbimeve mund të mos jenë të këmbyeshme kundrejt mallit ose shërbimit të premtuar në Librin e Bardhë të krypto-asetit, veçanërisht në rast dështimi ose ndërprerjeje të projektit.
  4. Çdo Libër i Bardhë i krypto-asetit duhet të përmbajë një deklaratë nga organi menaxhues i emetuesit të krypto-aseteve. Kjo deklaratë do të konfirmojë se Libri i Bardhë i krypto-asetit përputhet me kërkesat e këtij titulli dhe se, sipas njohurive më të mira të organit menaxhues, informacioni i paraqitur në letrën e bardhë të krypto-asetit është i saktë dhe se nuk ka asnjë lëshim domethënës.
  5. Çdo Libër i Bardhë i krypto-asetit duhet të përmbajë datën.
  6. Libri i Bardhë i krypto-aseteve do të hartohet në të paktën në një nga gjuhët zyrtare të Kosovës dhe/ose në anglisht.
  7. Libri i Bardhë i krypto-aseteve do të vihet në dispozicion në formate të lexueshme elektronike.
  8. BQK do të hartoj formë të caktuara dhe formularë për qëllime të ekzekutimit të kritereve nga ky nen.
  9. Deri në nxjerrjen e formave të veçanta, operatori mund të përdorë formë që i përmbledhin të gjitha informatat e parapara me këtë nen.

## **KAPITULLI VI NDALIMI I ABUZIMIT TË TREGUT**

### **Neni 24 Abuzimi i tregut**

1. Abuzimi i tregut përfshin:

- 1.1. manipulimin e tregut; dhe
- 1.2. tregtim bazuar në informacionin e privilegjuar.

2. Ndalimet dhe kërkesat që parashikohen në këtë kapitull, zbatohen mbi të gjitha veprimet e cilitdo personi juridik ose fizik, të cilat përbëjnë abuzim tregu, të përshkruara në këtë kapitull, ose të detajuar nëpërmjet akteve nënligjore të posaçme, të lëshuara nga autoriteti përgjegjës, në lidhje me tokenët digjitalë/valutat virtuale, të cilat pranohen për tregtim në një nga platformat tregtare, ose për të cilat është paraqitur kërkesa për t'u pranuar për tregtim në këtë bursë ose platformë.

### **Neni 25 Dispozita të përgjithshme të manipulimit të tregut**

1. Ky kapitull zbatohet në lidhje me të gjitha transaksionet me tokenët digjitalë/valutat virtuale për:

- 1.1. veprimet ose mosveprimet e kryera në Republikën e Kosovës në lidhje me transaksionet me tokenët digjitalë/valuta virtuale të çdo personi juridik, që është themeluar, ushtron veprimtari ose është listuar brenda ose jashtë Republikës së Kosovës;
- 1.2. veprimet ose mosveprimet e kryera jashtë Republikës së Kosovës në lidhje me transaksionet me tokenët digjitalë/valuta virtuale të cilitdo person juridik, që është themeluar ose ushtron veprimtari në territorin e Republikës së Kosovës;
- 1.3. veprimet që ndodhin në territorin e Republikës së Kosovës në lidhje me të gjithë tokenët digjitalë/valuta virtuale, pavarësisht nëse tregtohen brenda apo jashtë territorit të Republikës së Kosovës; dhe
- 1.4. veprimet që ndodhin jashtë territorit të Republikës së Kosovës në lidhje me të gjitha transaksionet me tokenët digjitalë/valuta virtuale, por që tregohen brenda territorit të Republikës së Kosovës.

### **Neni 26 Sjellja e jashtëligjshme që krijon treg të rremë**

1. Askush nuk duhet të kryejë apo të jetë shkak për kryerjen e çdo veprimi që synon:

- 1.1. të përcjellë një informacion të rremë apo mashtrues, sikur po kryhet tregtim i tokenëve digjitalë/valutave virtuale, një platformë tregtare; ose

- 1.2. të përcjellë një informacion të rremë apo mashtrues në lidhje me blerjen ose çmimin e cilitdo prej këtyre tokenëve digjitalë/valutave virtuale.
2. Askush nuk ka të drejtë që me anë të shitblerjes së tokenëve digjitalë/valutave virtuale, të cilat nuk përfshijnë ndryshim të përfituesit fundor të këtyre instrumenteve, ose nëpërmjet cilitdo transaksioni apo mjeti fiktiv, të mbajë, të rrisë, të ulë ose të shkaktojë luhatje në çmimin e tregut të çfarëdo virtuale apo digjitale.
3. Pa cenuar zbatimin e përgjithshëm të paragrafit 1 të këtij neni, personi kryen shkelje, nëse:
  - 3.1. zbaton, merr pjesë, përfshihet ose kryen, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, në çfarëdo lloj transaksioni shitblerjeje të tokenëve digjitalë/valutave virtuale, kur ky transaksion nuk sjell asnjë ndryshim të përfituesit fundor të tokenëve digjitalë/valutave virtuale përkatëse; ose
  - 3.2. paraqet ose merr masa që të paraqitet një ofertë për shitblerje të çfarëdo tokeni digjital/valute virtuale, për një çmim të caktuar, kur ka paraqitur ose ka marrë masat që të paraqitet, ose ka dijeni se një person i lidhur me të, ka paraqitur ose ka marrë masat që të paraqitet, një ofertë për shitblerje të të njëjtit token digjital/valutë virtuale, për një çmim që në thelb është i njëjtë me çmimin e parë të përmendur.
4. Në kuptim të këtij neni, shitblerja e tokenëve digjitalë/valutave virtuale nuk sjell ndryshim të përfituesit fundor, nëse personi i cili ka pasur interes mbi tokenin digjital/valutën virtuale përpara shitblerjes, ose personi i lidhur me të në raport me këta tokenë digjitalë/valutë virtuale, ka interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi instrumentet financiare edhe pas shitblerjes.
5. Transaksioni i shitblerjes së tokenit digjital/valutës virtuale, i përmendur në nënparagrafin 3.1. të këtij neni, përfshin:
  - 5.1. paraqitjen e një oferte për shitblerje të tokenëve digjitalë; dhe
  - 5.2. paraqitjen e një ftese, pavarësisht se si është shprehur, e cila shprehimisht apo në mënyrë të nënkuptuar, fton një person të ofrojë tokenë digjitalë/valuta virtuale për shitje apo blerje.
6. Shkeljet e dispozitave të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni përbëjnë vepër penale dhe dënohen sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

## **Neni 27** **Manipulimi i tregut**

1. Manipulim të tregut do të përbëjnë:

- 1.1. transaksionet ose urdhrat për tregtim, të cilat japin ose ka gjasa të japin sinjale të rreme, ose mashtruese në lidhje me ofertën, kërkesën, ose në lidhje me çmimin e tokenëve digjitalë/valutave virtuale, ose të cilat sigurojnë mbajtjen nëpërmjet një personi, ose disa personave që veprojnë në bashkëpunim, të çmimit të një ose disa prej tokenëve digjitalë/valutave virtuale në një nivel artificial, përveçse nëse personi i cili ka kryer transaksionin ose ka dhënë urdhrin për tregtim, vërteton se arsyet e tij për

ta bërë këtë veprim janë legjitime dhe këto transaksione ose urdhra tregtimi përputhen me praktikën e pranuar të tregut;

1.2. transaksionet ose urdhrat për tregtim, të kryera nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiktive ose çdo formë tjetër mashtrimi; dhe

1.3. shpërndarja e informacionit përmes mediave, përfshirë internetin ose me çfarëdo mjeti tjetër, i cili jep apo ka të ngjarë të japë sinjale të rreme ose mashtruese për tokenin digjital/valutën virtuale, përfshirë shpërndarjen e thashethemeve dhe lajmeve të rreme ose keqinformuese, në rastin kur personi që ka kryer shpërndarjen ka pasur dijeni, ose duhej të kishte pasur dijeni se informacioni ka qenë i rremë ose keqinformues.

2. Në lidhje me gazetaret, kur veprojnë në cilësinë e gazetarit, shpërndarja e informacionit do të vlerësohet duke mbajtur parasysh rregullat që rregullojnë profesionin e tyre, me përjashtim kur ata përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, përfitime materiale ose jo materiale, nga shpërndarja e informacionit në fjalë.

3. Në veçanti, do të konsiderohen manipulim tregu veprimtaritë dhe sjelljet e mëposhtme që rrjedhin nga përkufizimi i manipulimit të tregut sipas paragrafit 1 të këtij neni:

3.1. veprimtaria e një personi ose disa personave, të cilët veprojnë në bashkëpunim, për të siguruar një pozitë dominuese mbi ofertën ose kërkesën për një apo disa tokenë digjitalë/ valuta virtuale, me pasojë mbajtjen të pandryshueshme, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të çmimeve të shitblerjes të tokenëve digjitalë/valutave virtuale;

3.2. shitblerja e tokenëve digjitalë/valutave virtuale në mbyllje të tregut, me pasojë keqinformimin e investitorëve, të cilët veprojnë bazuar në çmimet e mbylljes; dhe

3.3. përfitimi nga përdorimi i rastësishëm ose i rregullt i mediave tradicionale apo elektronike për shprehjen e një opinioni mbi një token digjital/valutë virtuale ose, tërthorazi, mbi emetuesin e tij, pasi është mbajtur paraprakisht një qëndrim mbi këtë token digjital/valutë virtuale, duke përfituruar më pas nga ndikimi i opinionit të shprehur mbi çmimin e këtij tokeni digjital/valutë virtuale, pa informuar dhe deklaruar publikisht konfliktin e interesit.

## **Neni 28**

### **Ndalimi i manipulimit të tregut**

1. Askush nuk duhet të kryejë ose të përfshihet në kryerjen, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, të një numri transaksionesh me tokenë digjitalë/valuta virtuale, të cilat kanë ose mund të kenë si pasojë:

1.1. ngritjen e rreme;

1.2. uljen e rreme; apo

1.3. përcaktimin, mbajtjen ose stabilizimin e rremë të çmimit, ose të vëllimit të tregtimit të tokenëve digjitalë/valutave virtuale, me qëllim, ndër të tjera, nxitjen e personave të tjerë, për të blerë apo shitur këta tokenë digjitalë/valuta virtuale, ose tokenë

digjitalë/valuta virtuale të tjera, të lidhura me to, pavarësisht nëse këta persona e kanë apo jo këtë qëllim.

2. Në kuptim të këtij neni, transaksioni në lidhje me tokenë digjitalë/ valuta virtuale, përfshin:

2.1. paraqitjen e një oferte për shitblerjen tokenëve digjitalë/ valutave virtuale; dhe

2.2. paraqitjen e një ftese, pavarësisht si është shprehur, me të cilën shprehimisht ose në mënyrë të nënkuptuar ftohet një person që të ofrojë për të shitur apo blerë tokenë digjitalë/ valuta virtuale.

3. Shkelja e dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni përbën vepër penale dhe dënohet sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

### **Neni 29 Informacioni i privilegjuar**

1. Për qëllim të këtij neni, informacion i privilegjuar përfshin informacionin e një natyre precize, i cili nuk është bërë publik dhe që ka lidhje direkte ose indirekte, për një ose disa emetues, ose për një ose disa tokenë digjitalë/valuta virtuale, dhe i cili, në qoftë se do të bëhej publik, do të kishte një efekt të rëndësishëm në çmimet e këtyre tokenëve digjitalë/valutave virtuale, ose në çmimet e tokenëve digjitalë/valutave virtuale të tjera, të lidhura me to.

2. Për qëllimet e paragrafit 1 të këtij neni, informacioni do të konsiderohet se është i një natyre precize, nëse përmban rrethana të cilat ekzistojnë ose priten të ekzistojnë, ose një ngjarje e cila ka ndodhur ose pritet të ndodhë, në mënyrë të arsyeshme, dhe është mjaftueshëm specifik, për të nxjerrë një konkluzion si efekt i mundshëm i këtyre rrethanave, ose për të ndikuar çmimin e tokenëve digjitalë/valutave virtuale, ose çmimin e tokenëve digjitalë/valutave virtuale të tjera të lidhura me to.

3. Për qëllime të paragrafit 1 të këtij neni, informacioni i cili, nëse do të ishte bërë publik, do të kishte një efekt të rëndësishëm në çmimin e tokenëve digjitalë/valutave virtuale, nënkupton informacionin që një investitor i arsyeshëm do të përdorte pjesërisht ose plotësisht në marrjen e vendimeve për të investuar.

### **Neni 30 Ndalimi i tregtimit, bazuar në informacionin e privilegjuar**

1. Për qëllim të këtij neni, tregtimi, bazuar në informacionin e privilegjuar, ndodh atëherë kur një person zotëron informacione të privileguara dhe e përdor këtë informacion, duke blerë apo shitur, për llogari të vet ose për llogari të palëve të treta, direkt ose indirekt, tokenë digjitalë/valuta virtuale, me të cilat lidhet ky informacion.

2. Përdorimi i informacionit të privilegjuar, duke anuluar apo ndryshuar, një urdhër i cili lidhet me blerjen apo shitjen e tokenëve digjitalë/valutave virtuale, me të cilat lidhet ky informacion, dhe kur ky urdhër është vendosur përpara se personi në fjalë të zotëronte informacionin e privilegjuar, do të konsiderohet gjithashtu se përbën tregtimin, bazuar në informacionin e privilegjuar.

3. Ky nen zbatohet për të gjithë personat, të cilët zotërojnë informacion të privilegjuar, si më poshtë:

- 3.1. anëtarët menaxherialë apo mbikëqyrës të emetuesit;
- 3.2. personat që zotërojnë një pjesë të rëndësishme në kapitalin e emetuesit;
- 3.3. personat që kanë akses ndaj informacionit nëpërmjet punësimit, profesionit, apo detyrave të tyre; ose
- 3.4. personat që kanë akses në informacion të privilegjuar, pasi janë përfshirë në aktivitete kriminale.

4. Ky nen zbatohet dhe ndaj çdo personi që zotëron informacion të privilegjuar në rrethana të tjera, përveç atyre të referuara më sipër dhe kur ky person e di ose duhet ta dinte që ky informacion është i privilegjuar.

5. Kur personi është person juridik, ky nen do të aplikohet në përputhje me ligjin e fushës, ndaj personave fizikë që marrin pjesë në vendimmarrje, në lidhje me blerjen, shitjen, anulimin apo amendimin e një urdhri për emër dhe llogari të personit juridik në fjalë.

6. Shkelja e kërkesave të këtij neni përbën vepër penale dhe dënohet sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

### **Neni 31**

#### **Ndalimi i tregtimit, bazuar në informacionin e privilegjuar dhe zbulimit të jashtëligjshëm të informacionit të privilegjuar**

1. Asnjë person nuk mund:

- 1.1. të kryejë ose tentojë të kryejë tregtim të bazuar mbi informacionin e privilegjuar;
- 1.2. të rekomandojë që një person tjetër të tregtojë, bazuar në informacionin e privilegjuar; ose
- 1.3. të zbulojë në mënyrë të jashtëligjshme informacionin e privilegjuar.

2. Çdo veprim në kundërshtim me kërkesat e nenit 25 të këtij ligji dhe këtij neni, përbën vepër penale dhe dënohet sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe ligjeve të tjera në fuqi.

3. Autoritetet përgjegjëse nxjerrin akt nënligjor lidhur me rregullat dhe menaxhimin e kriptoseteve gjatë procedurës penale.

## **KAPITULLI VII DISPOZITAT NDËSHKIMORE DHE ANKIMIMI**

### **Neni 32 Sanksioni kundërvajtes me gjobë**

1. Personi juridik dënohet me gjobë prej pesëmijë (5.000) euro deri në njëzetmijë (20.000) euro, për kundërvajtje si në vijim:

1.1. ushtrimi i aktivitetit të rregulluar nga ky ligj, pa licencat ose autorizimet e autoriteteve përkatëse, në rastet kur këto aktivitete kërkojnë licencë dhe/ose autorizim;

1.2. mosdhënien apo fshehjen e informacionit, kur kërkohet nga autoritetet përgjegjëse në përputhje me këtë ligj; dhe

1.3. shkelje të dispozitave për abuzimin e tregut.

2. Për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni, personi përgjegjës i personit juridik dënohet me gjobë prej njëmijë (1.000) euro deri në tremijë (3.000) euro.

3. Për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni, personi fizik që ushtron biznes individual dënohet me gjobë prej dymijë (2.000) euro deri gjashtëmijë (6.000) euro.

4. Për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni, personi fizik dënohet me gjobë prej pesëqind (500) euro deri njëmijëepesëqind (1.500) euro.

### **Neni 33 Ankimimi**

1. Kundër çdo vendimi që nxjerrët në zbatim të këtij ligji, lejohet ankesa në pajtim me Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

2. Organi epror që shqyrton ankesat sipas këtij neni është Komisioni i Ankesave i themeluar me vendim të Ministrit të ministrisë përgjegjëse për financa.

3. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, Ministri me akt nënligjor përcakton përbërjen e komisionit dhe mandatin e anëtarëve të komisionit.

4. Puna dhe procedura e komisionit të ankesave bazohet në rregullat e përcaktuara për organet kolegjiale në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

5. Ndaj vendimeve të komisionit të ankesave pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente.

**KAPITULLI VIII  
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**Neni 34  
Aktet nënligjore**

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, brenda afatit prej gjashtë (6) muajsh, Ministria dhe BQK nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e tij.

**Neni 35  
Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr.08/L-295  
31 tetor 2024**

**Ligji shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.**